



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. _____ prot.

Tiranë, datë ____/____/2022.

RELACION

**MBI HARTIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË VEPRIMTARISË SË
ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE PËR VITIN 2023.**

Drejtorja e Përgjithshme me shkresën Nr. 3715, datë 10.11.2022 “Mbi hartimin e programit ekonomik dhe financiar të vitit 2023”, ka dhënë udhëzime për Degët Rajonale dhe Drejtoritë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së, për përgatitjen e programit ekonomik dhe financiar, të treguesve kryesor të të ardhurave, shpenzimeve të veprimtarisë, investimeve ndërtimore dhe jo ndërtimore, si dhe për çështje të tjera për aktivitetin e vitit 2023.

Në mbështetje të Ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar, VKM Nr. 198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave“, i ndryshuar, si dhe Statutin e EKB-së nr. 325/2 prot, datë 25.02.2019, gjatë muajit nëntor-dhjetor 2022, Degët Rajonale të EKB-së dhe Drejtoritë pranë Drejtorisë së Përgjithshme kanë punuar për përgatitjen e projekt-programit ekonomik dhe financiar për vitin 2023.

Për këtë, programi ekonomik i vitit 2023 është hartuar në bazë të trendit dhe eksperiencës të viteve të mëparshme për planifikimin e shpenzimeve të veprimtarisë. Të ardhurat janë parashikuar mbi bazën e produktit të gatshëm (apartamente, njësi shërbimi dhe garazhe) në dispozicion për të shitur, si në banesat e reja ashtu edhe banesat për privatizim, si dhe përdorimin me efektivitet të burimeve ekzistuese të Entit. Konkretisht të ardhurat e vitit 2023 përfshijnë:

- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm.
- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së.
- Të ardhurat nga interesat për kontratat e lidhura ndër vite nga Degët Rajonale të EKB-së.
- Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit dhe garazheve në banesat e ndërtuara me fondet e veta të EKB-së.
- Të ardhurat nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM.

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

- Të ardhurat nga 4% (pagesa e shpenzimeve operacionale për EKB-në), të llogaritur për kontratat e reja të apartamenteve dhe njësisë të banimit të objekteve me VKM.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare, për fondet e lira gjendje në bankat e nivelit të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme.
- Të ardhura të tjera, ku përfshihen të ardhurat nga biletat e parkut të automjeteve, të ardhurat nga gjobat dhe penalitetet, etj.

Në përfundim të punës së kryer nga Degët Rajonale të EKB-së për hartimin e këtij projekt-programi, janë përgatitur dhe pasqyruar treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të cilët janë rishikuar nga Drejtoria e Përgjithshme, për të bërë të mundur maksimalizimin e të ardhurave dhe përdorimin me efikasitet të shpenzimeve për vitin 2023.

Projekt-programi ekonomik dhe financiar i EKB-së që paraqesim Këshillit Drejtues, trajton çështjet kryesore si vijon:

- I. Objektivat e programit ekonomik dhe financiar.
- II. Planifikimi i treguesve ekonomik dhe financiar të veprimtarisë.
- III. Planifikim dhe detajimi i planit të investimeve ndërtimore.
- IV. Planifikimi i aktiviteteve mbështetëse.

I. Objektivat e Programit Ekonomik dhe Financiar.

Enti Kombëtar i Banesave në këtë projekt-program ka parashikuar burimet për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimimin e veprimtarisë së tij, në planifikimin e investimeve të reja si dhe vazhdimin e ndërtimeve të nisura gjatë vitit 2022.

Në varësi të programimit të treguesve kryesor, janë përcaktuar objektivat e Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2023, të cilat i paraqiten Këshillit Drejtues për miratim, së bashku me programin ekonomik-financiar, si më poshtë:

- 1- Të realizojë të ardhurat në shumën **179,672,000 lekë** gjatë aktivitetit ekonomik dhe financiar dhe të mbajë nën kontroll shpenzimet e veprimtarisë për **111,742,000 lekë**.
- 2- Të realizojë një rezultat financiar (fitim bruto) në shumën **67,930,000lekë**
- 3- Në fushën e investimeve, objektivi i vitit 2023 do të jetë:

*Përfundimi i banesave të nisur nga viti 2021 dhe 2022 në qytetet Vlorë, Has, Tropojë, Burrel dhe Delvinë.

*Fillimi i ndërtimit të banesave për të pastrehët në qytetet Shijak, Roskovec, Tropojë, Sarandë, Berat dhe Gjitokastër.

- 4- Të realizohet gjatë vitit, strehimi i 246 familjeve, nëpërmjet shitjes së apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së dhe me fondet e buxhetit të shtetit.
- 5- Të bëhet e mundur shitja e 31 njësive të shërbimit dhe 76 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 2 njësi shërbimi (Librazhd), 12 garazhe në Gramsh, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Vlorë, 24 garazhe dhe 1 njësi shërbimi në Kukës, 7 njësi shërbimi në Tropojë, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Has, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel.
- 6- Të ulet numri i klientëve debitorë në nivelin 15 % ose 90 debitorë të trashëguar nga gjëndja vitit 2022.
- 7- Të sigurohen çertifikatat e pronësisë të njësive të banimit për objektet me VKM që janë dhënë në administrim për privatizim EKB-së, ku programohen të lidhen 72 kontrata të reja, nga të cilat 27 në Tiranë dhe 45 në Durrës.

II. Programimi i Treguesve Ekonomik dhe Financiar të Veprimtarisë.

A. Planifikimi i të Ardhurave

Burimet kryesore të të ardhurave financiare për vitin 2023 për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të EKB-së do të jenë si më poshtë:

- a) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm
- b) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së në Vlorë, Has, Tropojë dhe Burrel.
- c) Të ardhurat nga 4%, ku përfshihen pagesa e shpenzimeve operacionale për EKB-në sipas vlerave të kontratave të reja të programuara për shitjen e apartamenteve dhe njësive të banimit të objekteve me VKM.
- d) Të ardhurat nga shitja e njësive të banimit të objekteve të privatizuara me VKM dhe lidhja e kontratave të reja nga Degët Rajonale në Tiranë dhe Durrës.
- e) Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit dhe garazhet në Fier, Librazhd, Korçë, Maliq, Kukës, Vlorë, Has, Tropojë dhe Burrel.
- f) Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura ndër vite dhe nga ato që do të lidhen gjatë vitit 2023.
- g) Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare për fondet e lira të EKB-së.
- h) Të ardhura të tjera ku përfshihen, të ardhurat nga parkimi i mjeteve të të tretëve, të ardhurat nga qiratë, gjobat e penaltitetet, etj.

Programi i të ardhurave sipas zërave kryesor, për Degët Rajonale të EKB-së dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqitet si më poshtë:


PROGRAMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2023

Në lekë

NR.	Emërtimi	Të ardhura nga shitja e apartamenteve	Të ardhura nga njësi shërbimi+garazhe	Të ardhura nga privatizime me VKM	Të ardhura nga 4 %	Të ardhura nga Interesat e kredive	Të ardhura Interesa depozita dhe bankare	Të ardhura te tjera	TOTALI
1	TIRANE			17,900,000	716,000	5,350,100		350,000	24,316,100
2	FIER		988,700		92,000	4,701,700		54,000	5,836,400
3	DURRES			50,912,500	2,100,000	5,571,000	6,500	120,000	58,710,000
4	BERAT					1,681,900		85,000	1,766,900
5	KORCE		588,600			7,200,000	5,000	145,400	7,939,000
6	GJIROKASTER	-			30,500	1,332,700		121,000	1,484,200
7	SHKODER	1,083,900				3,477,900		130,000	4,691,800
8	ELBASAN		2,071,000		-	4,250,000	7,000	150,000	6,478,000
9	VLORE	7,344,200	4,514,500	700,000	8,780,800	2,800,000	1,000	180,000	24,320,500
10	KUKES	1,644,860	7,248,500		6,656,040	7,033,800		60,000	22,643,200
11	DIBER	1,045,000	534,000		2,700,000	836,000		150,000	5,265,000
12	LEZHE	76,000			123,500	1,751,400		1,000,000	2,950,900
13	Dr. PERGJITH						9,270,000	4,000,000	13,270,000
	TOTALI	11,193,960	15,945,300	69,512,500	21,198,840	45,986,500	9,289,500	6,545,400	179,672,000

PROGRAMI I TE ARDHURAVE SIPAS ZERAVE PER VITIN 2023.

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al



Siç del nga pasqyra e mësipërme, në planin e të ardhurave për vitin 2023, të ardhurat nga shitja (apartamente + njesi shërbimi + garazhe) së bashku me të ardhurat nga 4% për shpenzimet operacionale zenë 27%, të ardhurat nga interesat e kontratave 26%, të ardhurat nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM 39%, të ardhurat nga interesat e depozitave bankare 6%, dhe të ardhurat e tjera 4%.

Më hollësisht programi i treguesve kryesor të të ardhurave nga shitja paraqiten si më poshtë:

Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e Apartamenteve

Gjatë vitit 2023 parashikohen të ardhura neto nga shitja në vlerën 80,706 mijë lekë, nga lidhja e rreth 246 kontrata të reja me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat, Vlorë 75, Has 35, Tropojë 25, Shkodër 10, Dibër 27 dhe Lezhë 2, dhe me fonde te buxhetit te shtetit, Tirana 27 dhe Durrësi 45.

Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e njësive të shërbimit dhe garazheve

Gjatë vitit 2023 janë planifikuar të shiten njësitë e shërbimit dhe garazhet për të cilat janë parashikuar shitja e 31 njësive të shërbimit dhe 76 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njesi shërbimi në Fier, 2 njesi shërbimi (Librazhd), 12 garazhe në Gramsh, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 6 njesi shërbimi në Vlorë, 24 garazhe dhe 1 njesi shërbimi në Kukës, 7 njesi shërbimi në Tropojë, 9 garazhe dhe 6 njesi shërbimi në Has, 9 garazhe dhe 6 njesi shërbimi në Burrel, që së bashku zenë shumën e të ardhurave neto 15,945 mijë lekë.

Të Ardhura nga Interesat e Kontratave të Lidhura

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

Gjatë vitit 2023, janë planifikuar të realizohen të ardhura nga interesat e kontratave të lidhura të klientëve që kanë përfituar apartamente, të ndërtuara nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit, Bankës Botërore dhe donatorë të tjerë.

Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura për këto apartamente, programohen në shumën prej **45,986 mijë** lekë.

Të Ardhurat nga 4% i Shpenzimeve Operacionale

Për vitin 2023 janë planifikuar të realizohen të ardhura nga 4% (shpenzime operacionale të EKB-së) nga shitja e apartamenteve të reja (Vlorë, Has, Tropojë dhe Burrel) si dhe apartamente të tjera të ndërtuara ndër vite me fondet e Buxhetit të Shtetit, si dhe nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM.

Për këtë vit janë programuar gjithësejt në shumën 21,199 mijë lekë, nga e cila për shitjet e apartamenteve në shumën 18,383 mijë lekë, dhe nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM në shumën 2,816 mijë lekë.

Të Ardhurat nga Interesat e Depozitave Bankare

Mbështetur në gjendjen e depozitave dhe mirëmenaxhimin e fondeve të lira monetare të Drejtorisë së Përgjithshme, për vitin 2023 janë planifikuar interesat nga depozitat bankare me afat maturimi një vjeçar dhe 6/mujor si dhe interesa të tjera bankare në shumën **9,290 mijë** lekë.

Të Ardhura të Tjera.

Këtu përfshihen të ardhurat e programuara nga shitja e biletave për parkimet e mjeteve ndaj të tretëve në shumën **4,000 mijë** lekë, si dhe të ardhurat nga kamatë-vonesat, penalitetet dhe të tjera në shumën **2,545 mijë** lekë.


Programimi i të ardhurave të vitit 2023 sipas zërave kryesor krahasuar me tre vite paraardhëse (Plan-Fakt) paraqiten si vijon:

Në lekë

NR	EMËRTIMI	2019		2020		2021		2022		2023
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan
1	Të ardhurat nga shitja	46,886,100	36,164,208	49,230,200	25,862,224	39,477,400	29,375,391	40,731,000	42,000,000	27,139,259
2	Të ardhura nga 4%	12,172,300	10,112,398	39,154,000	5,486,238	17,001,600	6,027,240	24,856,500	16,000,000	21,198,840
3	Privatizimet me VKM	33,023,900	38,217,736	38,225,000	38,268,244	42,718,000	40,986,251	43,185,000	83,500,000	69,512,500
4	Nga interesat e kontratave	37,370,900	39,990,976	39,237,700	41,683,199	37,899,200	40,723,287	41,490,150	40,000,000	45,986,500
5	Interesat depozitave	17,000,000	16,751,904	17,030,000	18,465,420	9,250,000	11,009,342	6,106,000	7,000,000	9,289,500

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

6	Të ardhura të tjera	4,723,400	14,067,229	7,261,700	9,597,127	7,753,800	20,630,715	6,718,200	4,000,000	6,545,400
	TOTALI	151,176,000	155,304,451	154,900,000	139,362,718	154,100,000	148,752,226	163,086,850	192,500,000	179,672,000



Siç del edhe nga të dhënat e tabelës si më sipër, rezulton se planifikimi i të ardhurave për vitin 2023 parashikohet në masën 10% më shumë se plani 2022 ose në vlerë 16,595 mijë lekë, dhe në masën 6% ose 12,328 mijë lekë më pak se i pritshmi 2022, të cilat sipas zërave kryesor janë programuar si vijon:

- “Të ardhurat nga shitja” e apartamenteve dhe njësive të shërbimit janë planifikuar 13,592 mijë lekë më pak nga plani 2022 dhe 14,861 mijë lekë më pak se i pritshmi 2022, kjo për shkak se:
 - a. Krahasuar me planin, për vitin 2022 është planifikuar shitja e njësive të shërbimit dhe apartamenteve të Sarandës në vlerë 8 milion lekë. Përveç kësaj në të ardhurat nga shitja e apartamenteve, ndikon shumë vlera e truallit e cila ndryshon nga qyteti në qytet.
 - b. Krahasuar me të pritshmin 2022, për shkak se apartamentet e Sarandës u shitën në treg të lirë me çmim tregu, gjeneruan të ardhura në vlerën 18 milion lekë, pra më të larta se sa të ardhurat nga shitja për të pastrehët.
- “Të ardhurat nga 4%” janë planifikuar në masën 15% më pak se plani i vitit 2022 dhe 32% më shumë se i pritshmi 2022, kjo pasi për 2022 ishin planifikuar të ardhura nga 4% për shitjen e apartamenteve të reja në Vlorë, Kukës, Has, Tropojë, Maliq dhe Sarandë, si dhe privatizimet në Tiranë dhe Durrës. Të ardhurat nga 4% për vitin 2022 nuk janë realizuar për shkak të mosshitjes të apartamenteve të banesës së Vlorës, Hasit dhe Tropojës, si dhe për shkak se apartamentet e Sarandës u shitën në ankand dhe, pavarësisht të ardhurave të larta të shitjes, nuk gjenerojnë të ardhura nga 4%. Për vitin 2023 janë parashikuar të ardhura nga 4% nga shitja e

apartamenteve të banesave të reja të Vlorës, Hasit, Tropojës dhe Burrelit ku, tre të fundit, kanë numër më të vogël apartamentesh si dhe privatizimet me VKM në Tiranë e Durrës.

- “Të ardhurat nga privatizimet”, janë planifikuar në masën 70% më shumë se plani i vitit 2022, por 17% më pak se i pritshmi 2022. Plani i vitit 2022 për këtë zë, u planifikua disi me rezerva për shkak të problemeve më banesën e duhan-cigares, të cilat filluan me lidhjen e kontratave në tremujorin e fundit të vitit 2022. Për vitin 2023 i kemi planifikuar më të ulta për shkak të limiteve të afatit ligjor të VKM nr. 898, i cili parashikon për kryerjen e procedurave të privatizimit, një afat 2 vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij akti nënligjor për objektet që janë të regjistruara kurse, për objektet ende të paregjistruara, afati 2 vjeçar fillon nga paisja me certifikatën e pronësisë.
- Të ardhurat nga interesat e kontratave janë me rritje prej 11% më shumë se plani 2022, dhe 11.5% më shumë se i pritshmi 2022, duke marrë parasysh lidhjen e kontratave të reja gjatë vitit 2022 dhe 2023.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave janë dhe interesat bankare të cilat janë planifikuar në masën 52% më shumë se plani i 2022 dhe 33% më shumë se i pritshmi 2022 për shkak të rritjes së normave të interesit të bankave.
- Të ardhurat e tjera janë planifikuar pak a shumë në nivelin e planit 2022 dhe rreth 50 % më shumë se i pritshmi. Në këtë zë përfshihen të ardhurat nga shitja e biletave të autoparkut, të ardhurat nga gabime të lejuara të viteve paraardhëse, kamatvonesat etj.

B. Planifikimi i Shpenzimeve të Veprimtarisë së EKB-së.

Në planifikimin e zërave kryesor të shpenzimeve është mbajtur parasysh që të përballohen nevojat më të domosdoshme për funksionimin normal të veprimtarisë së EKB-së për gjatë vitit 2023.

Konkretisht planifikimi i shpenzimeve për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të vitit 2023, pasqyrohen si më poshtë:

Në Lekë

NR.	Emërtimi	PLANI 2019	PLANI 2020	PLANI 2021	PLANI 2022	PLANI 2023
1.	Tiranë	5,063,000	5,029,000	6,099,500	5,997,000	6,916,500
2.	Fier	3,465,100	3,353,000	3,258,300	3,269,000	3,632,350
3.	Durrës	4,232,000	4,948,000	4,977,700	4,973,000	4,981,600
4.	Berat	2,459,600	2,371,000	2,378,200	2,396,000	2,585,800
5.	Korçë	3,445,500	3,353,000	3,351,100	3,325,000	3,702,960
6.	Gjirokastër	3,093,300	2,596,000	3,026,900	3,040,000	3,482,160

7.	Shkodër	3,274,400	3,214,000	3,252,900	3,414,000	3,965,140
8.	Elbasan	3,443,400	3,442,000	3,497,800	3,475,000	4,150,090
9.	Vlorë	3,491,100	3,403,000	3,387,100	3,387,000	3,696,650
10.	Kukës	2,139,400	2,130,000	2,135,100	2,461,000	2,727,000
11.	Dibër	2,347,700	2,355,000	2,386,200	2,295,000	2,609,550
12.	Lezhë	3,321,500	3,543,000	2,431,200	2,711,000	2,859,200
13.	Dr.Përgjithshme	58,400,000	58,163,000	60,218,000	64,173,000	66,433,000
	TOTALI	98,176,000	97,900,000	100,400,000	104,916,000	111,742,000

Më hollësisht programimi i shpenzimeve të veprimtarisë sipas nënzërave kryesor të tyre për vitin 2023, krahasuar me planet e katër viteve paraardhëse, paraqitet si më poshtë:

Në Lekë

NR.	ZËRAT KRYESOR TË SHPENZIMEVE	PLANI 2019	PLANI 2020	PLANI 2021	PLANI 2022	PLANI 2023
1.	Shpenzime administrative	2,335,000	2 174 000	2 225 000	2,277,400	2,600,000
2.	Shpenzime Energji-Ujë	1 583 000	1 459 300	1 306 000	1,385,500	1,456,500
3.	Shpenzime Udhëtime-Dieta	2 092 000	2 070 000	2 116 000	2,205,000	2,209,840
4.	Shpenz Postare-Telefonike	1 150 000	1 132 000	1 120 400	1,189,600	1,140,000
5.	Komisione Bankare	152 100	160 400	183 400	235,000	293,000
6.	Pagat e Punonjësve	63 730 600	63 445 200	65 267 800	68,476,000	73,226,423
7.	Kontributet Sig. Shoqërore	10 684 100	10 597 600	10 899 800	11,357,000	12,617,360
8.	Shpenzime Tatim Taksa	397 300	359 500	957 400	941,300	870,800
9.	Shpenzime Pritjeje	50 000	50 000	80 000	90,000	100,000
10.	Shpenzime rojeve autopark	2 200 000	2 100 000	2 100 000	2,205,000	2,174,400

11.	Shpenzime Eksperti Kontabël	1 200 000	1 400 000	1 400 000	1,400,000	1,400,000
12.	Honorare Këshilli Drejtues	1 800 000	2 100 000	2 100 000	2,205,000	2,113,500
13.	Trajnime e Seminare	280 000	280 000	120 000	120,000	120,000
14.	Penalitete e Gjoha	1 750 000	2 100 000	800 000	800,000	100,000
15.	Shpenzime Riparime	850 000	1 000 000	1 650 000	1,200,000	1,480,000
16.	Mirëmbajtje e programit Alpha, të tjera	450 000	240,000	300 000	400,000	200,000
17.	Shpenzime e Qera zyresh	707 000	707 000	1 095 100	1,232,100	1,357,100
18.	Shpenzime Amortizimi	3 816 250	3 991 600	3 748 200	3,850,100	3,862,030
19.	Shpenzime të tjera	761 500	859 000	1 955 200	1,362,300	1,761,000
20.	Shpenzime 1% të përndjekurit	637 150	634 400	652 700	684,700	730,047
21.	Reklamime TV - dyqanet	400 000	240 000	120 000	100,000	50,000
22.	Shpenzime antarësimi housing	400 000	400 000	400 000	400,000	400,000
23.	Zbritje akorduar klientëve					680,000
24.	Shpenzime hapje të gjyqeve	350 000	2 100 000	800 000	800,000	800,000
	SHUMA	98 176 000	97 900 000	100,400,000	104,916,000	111,742,000

Siç del nga tabela më sipër, shpenzimet e veprimtarisë për vitin 2023 janë programuar më tepër 6,826 mijë lekë krahasuar me vitin 2022, kjo si efekt i rritjes së pagave e cila ndikon edhe në rritjen e shpenzimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Të gjitha zërat e tjerë janë planifikuar në nivelet e viteve të mëparshme.

Mbështetur në treguesit e programuar të të ardhurave dhe shpenzimeve të veprimtarisë, rezultati financiar i planifikuar për çdo Degë Rajonale të EKB-së dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqiten si vijon;


PLANIFIKIMI I REZULTATIT FINANCIAR PER VITIN 2023.

Në lekë

NR.	EMËRTIMI	PLANI I TË ARDHURAVE	PLANI I SHPENZIMEVE	Rezultati financiar ose e ardhura neto (Fitimi)	Në %
1	TIRANE	24,316,100	6,916,500	17,399,600	25.6
2	FIER	5,836,400	3,632,350	2,204,050	3.2
3	DURRES	58,710,000	4,981,600	53,728,400	79.1
4	BERAT	1,766,900	2,585,800	-818,900	-1.2
5	KORCE	7,939,000	3,702,960	4,236,040	6.2
6	GJIROKASTER	1,484,200	3,482,160	-1,997,960	-2.9
7	SHKODER	4,691,800	3,965,140	726,660	1.1
8	ELBASAN	6,478,000	4,150,090	2,327,910	3.4
9	VLORE	24,320,500	3,696,650	20,623,850	30.4
10	KUKES	22,643,200	2,727,000	19,916,200	29.3
11	DIBER	5,265,000	2,609,550	2,655,450	3.9
12	LEZHE	2,950,900	2,859,200	91,700	0.1
13	Dr. PERGJITH	13,270,000	66,433,000	-53,163,000	-78.3
	SHUMA	179,672,000	111,742,000	67,930,000	100

Rezultati financiar për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 67,930 mijë lekë, nga 58,171 mijë lekë lekë që ishte planifikuar në vitin 2022, me rritje në masën 16.8%. Për vitin 2023 me humbje është planifikuar Dega Berat e cila, të ardhurat për këtë vit, i siguron vetëm nga interesat pasi nuk ka në dispozicion apartamente për të shitur ose privatizuar. Në fakt, Dega Rajonale Berat, ka 15 apartamente të trashëguara nga ish-Komunale Banesa dhe të përfunduara nga EKB, por janë të palegalizuara për shkak dokumentacionit jo të plotë dhe të ekspertizës teknike për të cilat janë planifikuar fondet e nevojshme për tu kryer gjatë vitit 2023. Për shkak të procedurave të cilat zgjasin nuk janë parashikuar për tu shitur gjatë 2023. Gjithashtu me humbje është planifikuar Dega Gjirokastrer pasi nuk ka apartamente në dispozicion për të shitur, përveç dy apartamenteve për privatizim, të cilat për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit, sigurojnë të ardhura minimale. Gjithsesi Dega Gjirokastrer ka banesën e Delvinës e cila parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2023 dhe është gati për tu shitur në fillim të vitit 2024. Gjithë degët e tjera janë planifikuar me rezultat pozitiv.

Emërtimi	Plani 2019	Fakti 2019	Plani 2020	Fakti 2020	Plani 2021	Fakti 2021	Plani 2022	I pritshmi 2022	Plani 2023
Të ardhurat	151,176,000	155,304,451	159,853,500	139,362,718	155,334,000	148,752,226	163,087,000	192,500,000	179,672,000
Shpenzimet	98,176,000	96,257,671	102,693,200	92,912,571	100,400,000	94,238,832	104,916,000	98,238,832	111,742,000
Rezultati Financiar	53,000,000	59,046,780	57,160,300	46,450,147	54,934,000	54,513,394	58,171,000	94,261,168	67,930,000



Siç shihet fitimi i pritshëm i vitit 2022 është i lartë si rezultat i shitjeve të 25 apartamenteve të banesës në Maliq, shitja e 70 apartamenteve të banesave në Kukës, në të cilat rezultuan edhe të ardhura shtesë nga sipërfaqja tepër, shitja e dy njësjive të shërbimit dhe 2 apartamenteve në Sarandë, por kryesisht nga lidhja e rreth 40 kontratave të apartamenteve të përfuara nga ish-depot e duhan-cigares të kthyer në banesa me fondet e buxhetit dhe për këte arsye nuk ngarkojnë koston.

Rezervat dhe Risqet

1. Në programin ekonomik dhe financiar të vitit 2023, janë planifikuar të ardhura nga lidhja e rreth 246 kontrata të reja me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat, Vlorë 75, Has 35, Tropojë 25, Shkodër 10, Dibër 27 dhe Lezhë 2, dhe me fonde të buxhetit të shtetit, Tirana 27 dhe Durrësi 45 kontrata.

Realizimi i këtyre të ardhurave do të kenë ecuri normale për lidhjen e kontratave me familjarët e pastrehë, nëse nuk do të kemi pengesa për sigurimin në afat të certifikatave të pronësisë si dhe për listat e familjeve nga Këshillat Bashkiak sic kishim probleme gjatë vitit 2022, në sigurimin e certifikatave të pronësisë për pallatin e INSIGUT si dhe listat e të pastrehëve për 75 apartamenteve të Vlorës.

Gjithashtu mbështetur në analizën e koston së ndërtimit të banesave, analizës së çmimeve të shitjes të apartamenteve dhe gjëndjes ekonomike të banorëve të bashkive, rezulton se propabiliteti dhe impakti i

riskut vlerësohet i ulët dhe nuk ka efekt financiar në mos realizimin e të ardhurave, kjo duke marrë shkas në shitjen e menjëhershme të apartamenteve në banesat e reja në Kukës dhe Maliq.

2. Plotësimi i planit të të ardhurave nga shitja e 31 njësive të shërbimit dhe 76 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 2 njësi shërbimi (Librazhd), 12 garazhe në Gramsh, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Vlorë, 24 garazhe dhe 1 njësi shërbimi në Kukës, 7 njësi shërbimi në Tropojë, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Has, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel, mund të reduktohet për mungesë ofertash nga subjektet e interesuara, dhe paraqet risk për qytetet e vogla si Gramshi dhe Maliqi duke parë ecurinë e shitjeve gjatë dy viteve të fundit.

3. Nga planifikimi i të ardhurave nga 4% të cilat janë të lidhura me shitjen e apartamenteve si dhe nga privatizimet me VKM, të ardhurat nga interesat e kontratave dhe të ardhurat e tjera, parashikojmë të plotësojmë ritmiksht planin sipas programimit dhe nuk mendojmë të kemi risk ose mos realizime, kjo vërtetohet edhe mbi bazën e rezultateve të arritura në vitet e kaluara, që këto zëra kryesor kanë dhënë të ardhura suplementare mbi planin vjetor.

4. Planifikimi i arkëtimeve nga shitja, është bërë mbi bazën e detyrimeve që kanë klientët për pagesat e kësteve mujore dhe vjetore, si dhe është mbajtur në konsideratë ndjekja ritmike e arkëtimeve nga këstet e planifikuara të kredive dhe të interesave të kontratave, duke zbatuar procedurat e Manualit “Politikave dhe Procedurat e Menaxhimit të Debitorëve”.

Për këtë do kryejmë analizat përkatëse në bashkëpunim me degët do të marrim masat përkatëse për debitorët duke zbatuar kërkesat e manualit mbi menaxhimin e debitorëve, duke u dhënë mundësitë e lidhjes së akt-marrëveshjeve përkatëse, ose për debitorët që nuk ofrojnë mundësi pagese do të ndërmerren hapat ligjore nëpërmjet proceseve gjyqësore. Nisur nga eksperiencat e mëparshme, gjatë vitit pakësohen një numër debitorësh më të lartë se sa krijohen të rinj gjatë vitit dhe gjendja e detyrimeve të debitorëve vjen në ulje nga viti në vit, dhe do të përpiqemi të minimizojmë riskun për realizimin e planit të arkëtimeve.

5. Programimi i investimeve ndërtimore për vitin 2023 është në shumën 956,350 mijë lekë për ndërtimin e 6 banesave të reja me kosto të ulët nga të cilat 3 banesa janë të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe 3 banesa të tjera (Berat, Sarandë dhe Gjirokastrë) që mund të miratohen gjatë vitit në vazhdim pasi të kryehen analizat e riskut .

Informojmë se për çdo banesë në ndërtim është bërë më parë analiza teknike e ndërtimit dhe e riskut dhe më pas janë miratuar me vendim të Këshillit Drejtues, dhe nuk parashikohet risk lidhur me fondet e financimit të cilat janë nga burimet e veta të EKB-së. Për këtë më parë se të programohet nga Drejtoria Ekonomike është bërë parashikimi i Cash Floë-t për vitin 2023, ku rezulton se niveli i gjendjes së arkëtimeve dhe fondeve të depozitave mund të përballojnë financimin e investimeve në proces dhe të shpenzimeve të aktivitetit të EKB-së për vitin 2023 dhe 2024, por në fund të vitit 2024 parashikojmë që të mbeten likuiditete të lira dhe në depozitat bankare rreth **171 milion lekë**, i cili është parashikuar në kushtet e realizimit të shitjeve sidomos në banesat e reja, dhe arkëtimin e 4% dhe 10% në mënyrë të menjëhershme.

III. Planifikimi dhe Detajimi i Planit të Investimeve Ndërtimore për Vitin 2023.

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

Për vitin 2023, parashikimi i investimeve është hartuar vetëm me ato Bashki që kanë ofruar sheshe ndërtimi dhe janë angazhuar të bashkëpunojnë duke siguruar sheshe ndërtimi të cilat kanë leverdisshmëri. Aktualisht EKB ka siguruar sheshe ndërtimi dhe po vazhdohet me ndërtimin e banesave në qytetet Vlorë, Has, Tropojë, Burrel dhe Delvinë.

Në disa qytete, si në Roskovec dhe Shijak për të cilat është miratuar ndërtimi i banesave në Këshillin Drejtues, po vijon puna për realizimin e të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për nisjen e investimeve.

Në fushën e investimeve, objektivi i vitit 2023 do të jetë:

- a. Përfundimi i banesave të nisur nga viti 2021 në qytetet Vlorë II, Has dhe Tropojë;
- b. Vazhdimi i punimeve në banesat Burrel dhe Delvinë;
- c. Fillimi i ndërtimit të banesave për të pastrehët në qytetet Shijak dhe Roskovec;
- d. Vijimi i procedurave për ndërtim banesa në qytetet Sarandë, Gjirokaster, Tropoja II, Berat.
- e. Zgjerimin e bashkëpunimit të EKB-së me organet e vetëqeverisjes vendore, për sigurimin e shesheve të ndërtimit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët për strehimin e familjeve të pastreha sikurse është planifikuar Berati, Tropoja 2, Saranda dhe Gjirokastra për të cilin ka patur disa takime/komunikime dhe korrespondenca ndërinstytucionale.
- f. Parashikimi dhe Detajimi i Planit të Investimeve Ndërtimore vetëm për shpenzimet e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes, etj.

Nr.	Emërtimi objektit	Vlera e investimit gjatë 2023
A	Investime të vitit 2023	668,270,000
1	Objekti, Tropoja 2	103,720,000
	Ndërtim për banesën në Tropojë, nr. 2	96,000,000
	Mbikëqyrje Punimesh banesa në Tropojë, nr. 2	1,200,000
	Projekt mirembajtje banesa, në Tropojë, nr. 2	60,000
	Performanca e Energjise faza I, Tropojë nr. 2	800,000
	Performanca e Energjise faza II, Tropojë nr. 2	800,000
	Kolaudim objekti, Tropojë nr. 2	200,000
	Sigurim objekti, Tropojë nr. 2	960,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE, MNZ, Tropojë nr. 2	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza të ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj), Tropojë nr. 2	1,500,000
2	Objekti Sarandë	105,740,000
	Ndërtim për banesën në Sarandë	98,000,000
	Mbikëqyrje Punimesh, banesa në Sarandë	1,200,000

	Projekt mirembajtjeje, banesa Sarandë	60,000
	Performanca e Energjise faza I, Sarandë	800,000
	Performanca e Energjise faza II, Sarandë	800,000
	Kolaudim objekti, Sarandë	200,000
	Sigurim objekti, Sarandë	980,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Sarandë	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj), Sarandë	1,500,000
3	Objekti Roskovec	103,720,000
	Ndërtim për banesën në Roskovec	96,000,000
	Mbikqyrje Punimesh, Roskovec	1,200,000
	Projekt mirembajtjeje, banesa Roskovec	60,000
	Performanca e Energjise faza I, Roskovec	800,000
	Performanca e Energjise faza II, Roskovec	800,000
	Kolaudim objekti, Roskovec	200,000
	Sigurim objekti, Roskovec	960,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Roskovec	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj), Roskovec	1,500,000
4	Objekti Berat	144,410,000
	Ndërtim për banesën në Berat	135,000,000
	Mbikqyrje Punimesh, Berat	1,250,000
	Projekt mirembajtjeje, banesa Berat	60,000
	Performanca e Energjise faza I, Berat	1,200,000
	Performanca e Energjise faza II, Berat	1,200,000
	Kolaudim objekti, Berat	250,000
	Sigurim objekti, Berat	1,350,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Berat	2,600,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj), Berat	1,500,000
5	Objekti Gjirokastër	105,740,000
	Ndërtim për banesën në Gjirokastër	98,000,000
	Mbikqyrje Punimesh, Gjirokastër	1,200,000
	Projekt mirembajtjeje, banesa Gjirokastër	60,000
	Performanca e Energjise faza I, Gjirokastër	800,000
	Performanca e Energjise faza II, Gjirokastër	800,000

	Kolaudim objekti, Gjirokastrë	200,000
	Sigurim objekti, Gjirokastrë	980,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Gjirokastrë	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj), Gjirokastrë	1,500,000
6	Objekti Shijak	104,940,000
	Ndërtim për banesën në Shijak	98,000,000
	Mbikqyrje Punimesh, Shijak	1,200,000
	Projekt mirembajtje, Objekti Shijak	60,000
	Performanca e Energjise faza II, Objekti Shijak	800,000
	Kolaudim objekti, Shijak	200,000
	Sigurim objekti, Shijak	980,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Objekti Shijak	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Objekti Shijak	1,500,000
B	Investime të mbartur nga viti 2022	283,080,720
1	Objekti Vlora 1	800,000
	Pagesa e rojeve, Energji elektrike, etj.	800,000
2	Objekti Kukës	600,000
	Pagesa e rojeve, Energji elektrike, etj.	600,000
3	Objekti Has	30,526,720
	Ndërtim Objekti Has	23,394,690
	Mbikëqyrje Punimesh Objekti Has	272,030
	Kolaudim objekti Has	250,000
	Projekt mirembajtje, Objekti Has	60,000
	Performanca e Energjise faza II, Objekti Has	1,200,000
	Sigurim objekti, Has	1,250,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Objekti Has	2,600,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, ruajtje objekti, etj.), Objekti Has	1,500,000
4	Objekti Vlora 2	107,075,000
	Ndërtim për 2 banesave në Vlorë 2	97,000,000
	Mbikëqyrje për 2 banesave në Vlorë 2	1,225,000
	Projekt mirembajtje, Objekti Vlorë 2	60,000
	Performanca e Energjise faza II, 2 banesa Vlorë 2	2,400,000
	Kolaudim objekti 2 banesa, Vlorë 2	250,000

	Sigurim objekti 2 banesa, Vlorë 2	2,040,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, 2 banesa, Vlorë 2	2,600,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), 2 banesa Vlorë 2	1,500,000
5	Objekti Tropojë	14,150,000
	Ndërtim për banesën në Tropojë	8,000,000
	Mbikqyrje Punimesh Tropojë	400,000
	Projekt mirembajtje, Objekti Tropojë	60,000
	Performanca e Energjise faza II, 2 banesa Tropojë	800,000
	Kolaudim objekti, Tropojë	200,000
	Sigurim objekti, Tropojë	990,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Objekti Tropojë	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Objekti Tropojë	1,500,000
6	Objekti Burrel	53,249,000
	Ndërtim për banesën në Burrel	47,000,000
	Mbikqyrje Punimesh Burrel	680,000
	Projekt mirembajtje, Objekti Burrel	60,000
	Performanca e Energjise faza II, Objekti Burrel	800,000
	Kolaudim objekti, Burrel	200,000
	Sigurim objekti, Burrel	809,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Objekti burrel	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Objekti Burrel	1,500,000
8	Objekti Delvinë	76,680,000
	Ndërtim për banesën në Delvinë	70,000,000
	Mbikqyrje Punimesh Delvinë	1,100,000
	Projekt mirembajtje, Objekti Delvinë	60,000
	Performanca e Energjise faza II, Objekti Delvinë	800,000
	Kolaudim objekti, Delvinë	200,000
	Sigurim objekti, Delvinë	820,000
	Regjistrim ASHK+ pika lidhje UKT, OSHEE , MNZ, Objekti Delvinë	2,200,000
	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Delvinë	1,500,000

C	Studime-projektme (230) për VNM, studime zismike & gjeologjik, rievime, raporte ekspertize, rishikim detajesh të të projekteve, përshtetje e kuotës 00 etj., të objekteve të parashikuara për periudhën 2023-2024.	5,000,000
	SHUMA A+B+C	956,350,720

Për vitin 2023 janë planifikuar kryerja e investimeve për ndërtimin e objekteve sipas të dhënave të tabelës si më sipër në shumën 283,080,720 lekë me TVSH për financimin e investimeve të mbartura nga viti 2022 dhe ato të reja si dhe të shpenzohen 668,270,000 lekë me TVSH për investimet e reja.

Më poshtë jepen disa sqarime lidhur me investimet e mbartura apo në vazhdimësi si dhe ato të planifikuara për vitin 2023:

1. Banesë dhe shërbime 8k me një kat parkim nën tokë në qytetin e Hasit (35 apartamente).

Banasa 8k që po ndërtohet në qytetin e Hasit është miratuar me vendimin Nr.30, datë 28.6.2019,. Puna në këtë objekt ka filluar në datën 12.10.2020 dhe afati realizimit është 423 ditë kalendarike. Sipërmarrës për këtë objekt është BOE “LALA” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k referuar kontratës me Nr 1031/2prot., datë 05.10.2020 dhe vlerë 108,334,552 lekë me TVSH.

Më tej me nisjen e punës, për shkak të temperaturave të ulëta dhe ngricave gjatë perjudhës së dimrit ka patur mjaft ditë pezullim punimesh duke respektuar kushtet teknike të betonimit të strukturave monolite dhe realizimit të proceseve të ndryshme. Ky objekt ka qënë më i prekuri në aspektin kohor të “ecurisë normale sipas grafikut” pasi për shkak të lartësisë mbi nivelin e detit temperaturat shumicën e kohës (muajt Dhjetor, Janar, Shkurt dhe Mars) kanë qënë nën zero dhe proceset e punës në objekt janë të lidhura drejtpërdrejt me motin. Për këtë arsye kontrata e realizimit të këtij objekti, është shtyrë me 123 ditë kalendarike. Data e përfundimit të punimeve dhe kontratës është 08.12.2021. Në mënyrë të vazhdueshme nga ana e EKB-së i është tërhequr vëmendje shoqërisë sipërmarrëse për ritjen e rendimentit të punës dhe shtimin e fuqisë puntore për realizimin e objektit.

Referuar situatës faktike të punimeve të realizuara në objekt me gjithë shtyrjen 123 ditë kontrata nuk ka përfunduar sipas afatit. Aktualisht ecuria e punimeve është 85 % e vlerës së kontratës. Ka përfunduar konstruksioni, muratura, suvatimet, veshja me kapot, hidroizolimet, shtresa me pllaka, dyert e jashtme, pjesërisht dritaret. Janë realizuar punimet hidraulike, elektrike dhe bojatisja.

Vlera e aktuale e situacioneve pjesore, të likujduara deri më sot sipas realizimit aktual në objekt, është 106,046,650 lek me tvsh, pra vetëm 85 % e vlerës së kontratës.

Puna në objekt sipas kontratës duhej të përfundonte në datën 8 Dhjetor 2021, por referuar situatës faktike ky objekt ka vazhduar punimet edhe jashtë afatit kontraktual dhe ndaj shoqërisë sipërmarrëse janë aplikuar penalitete për çdo ditë vonesë sipas kushteve të kontratës.

Me regjistrimin final të objektit në ASHK si dhe marrjen e listave përfundimtare të familjeve nga Bashkia Has, EKB do të vijojë me shitjen e apartamenteve, njësave të shërbimit dhe garazheve të këtij objekti.

2. Dy banesa 8 kat me 1 kat nën tokë, nga këto njëra me ambiente shërbimi në katin përdhe në qytetin e Kukësit (Përfunduar 70 apartamente).

Investimi i përfunduar në qytetin e Kukësit është miratuar me vendimin Nr. 42, datë 31.10.2019 me vlerë 260,874,123 lekë me TVSH. Puna për ndërtimin e këtyre banesave ka filluar në 30.09.2020 dhe afati i ndërtimit është 365 ditë kalendarike. Ky investim u zbatua nga sipërmarrës BO “Geci” sh.p.k. & “Kevin Konstruksion” sh.p.k, referuar kontratës së me Nr.1030/1.prot, datë 02.09.2020, me vlerë kontrate 255,066,790 lekë me TVSH me një kursim 1%. Mbikëqyrës është shoqëria “GB Civil Engineering” SH.P.K. me vlerë kontrate 2,532,780 lekë me TVSH.

Objekti ka përfunduar punimet sipas afatit kontraktual si dhe është bërë kolaudimi i tij në datë 20.08.2022. Vlera përfundimtare e realizimit të kontratës sipas situacionit përfundimtar është 239,847,760 me TVSH.

Aktualisht janë lidhur kontratat me perfituesit familjare, sipas listes se miratuar nga Bashkia Kukes. Apartamentet janë populluar. Objekti është në ruajtje nga ana jone deri ne momentin e blerjes nga bashkia Kukes e ambjenteve te katit perdhe. Nga ana jone po vijon puna për shitjen e garazheve të këtij objekti.. EKB planifikon shitjen brenda tremujorit të parë të vitit 2023.

3. Dy banesa 8 kat me 1 kat nën tokë, nga këto njëra me ambiente shërbimi në katin përdhe në qytetin e Vlorës (Vlora II) 75 apartamente.

Për investimin e miratuar me vendim Nr. 24 datë 08.07.2020 me vlerë 271,400,000 të Këshillit Drejtues. Aktualisht ky investim po zbatohet nga sipërmarrës BOE, “ED KONSTRUKSION” sh.p.k & “NDËRTIMI” sh.p.k, “COLOMBO” sh.p.k referuar kontratës së me Nr.2073/3 prot, datë 24.02.2021, me vlerë kontrate 203,924,767 lekë me TVSH. Puna në objekt ka filluar në datë 11.03.2021 dhe afati për realizimin e kontratës është 400 ditë kalendarike. Në mënyrë të detajuar sqarojmë si vijon:

Zbatimit i Kontratës së Sipërmarrjes me nr. Prot. 2073/3, datë 24.02.2021 me BOE shoqërinë “ED-KONSTRUKSION” SH.P.K., dhe shoqërinë “NDËRTIMI” SH.P.K., “COLOMBO”SH.P.K., dhe Kontratës së Shërbimit të Mbikëqyrjes me nr. Prot. 2284/2, datë 24.12.2020 me BOE shoqërinë “Transport Highëay Consulting” SH.P.K. dhe shoqërisë “Erald-G” SH.P.K., nga fillimi i punimeve deri tani janë hasur problematika të shumta të krijuara nga situata e pandemise dhe rritja e çmimeve te materialeve te ndertimit. Ne kete situate referuar aktit normativ nr.10 date 18.05.2022, u ndërprepunimet. Në vijim si rrjedhojë e kërkesës së shoqërive sipërmarrëse është ndryshuar përfaqësuesi ligjor i dy shoqërive “Colombo”Sh.P.K, me Puna në objekt ka rifilluar menjëherë pas nënshkrimit të amendimit të ri të kontratës me nr.3498 prot., datë 15.10.2021. Aktualisht kane përfunduar punimet e karabinasë si dhe ka filluar ndërtimi i muraturës në katin përdhe. Ecuria e punimeve është 62 % e punimeve.

Për këtë investim Drejtoria Teknike e EKB planifikon të marrë masat dhe të ndjekë me prioritet çdo problematikë të lindur në mënyrë që ky objekt të arrijë të mbyllet brenda 6 mujorit të vitit 2023. Me regjistrimin final të objektit në ASHK si dhe marrjen e listave përfundimtare të familjeve nga Bashkia Vlorë, EKB do të vijojë me shitjen e apartamenteve, njësive të shërbimit dhe garazheve të këtij objekti.

4. Banesë 6 kate, nga këto 5 kate banimi, një kat i alternuar njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nën tokë, në qytetin e Maliqit. (Përfunduar 25 apartamente)

Objekti ka përfunduar punimet sipas afatit kontraktual si dhe është bërë kolaudimi i tij në datë 18.01.2022. Vlera përfundimtare e realizimit të kontratës sipas situacionit përfundimtar është 76,366,727 me TVSH.

Nga ana e Drejtorisë Teknike u realizuan Projekti i Mirëmbajtjes, Sigurimi i objektit dhe Rregjistrimi, pajisja me Çertifikatë Pronesie. Jane lidhur kontratat me qytetaret perfitues. Objekti është populluar.

Kemi realizuar shitjen e katit përdhe- kopesht e çerdhe për femije, sipas marrëveshjes dypalëshe me Bashkinë Maliq.

Po vijohet me procesin e shitjen garazheve të këtij objekti.

5. Banesë dhe shërbime 6k në qytetin e Bajram Currit- Bashkia Tropojë (25 apartamente)

Për investimin e miratuar me vendim Nr. 28 datë 08.07.2020 me vlerë 98,200,000 lekë me TVSH. Kontrata e lidhur me nr. 2025/3 prot., datë 04.03.2021 me shoqërinë sipërmarrëse është BOE "SHËNDELLI" sh.p.k & "HALILI" sh.p.k. dhe ka afat realizimi 365 ditë kalendarike pas fillimit të punimeve.

Punimet kanë filluar në datën 08.03.2021, dhe aktualisht në objekt janë duke realizuar punimet për kompletimet përfundimtare. Punimet për katet e banimit kanë përfunduar në datë 11.10.2022. Refeuar kërkesës së Bashkisë Tropojë në lidhje me vendosjen në dispozicion të katit përdhe dhe -1 (garazhet) për nevojat e saj (Qëndër Komunitare) jemi në hapat e fundit të lidhjes e kontrates me bashkinë e Bajram Currit.

Me plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm, regjistrimin final në ASHK të objektit si dhe marrjen e listave përfundimtare të familjeve nga Bashkia Tropojë, EKB do të vijojë me shitjen e apartamenteve, garazheve si dhe njësive të shërbimit. Kjo parashikohet të realizohet në tremujorin e parë të 2023.

6. Banesë dhe shërbime 6k me një kat nën tokë në qytetin e Burrelit- Bashkia Mat. (25 apartamente)

Për investimin e miratuar me vendim Nr.41, dt 22.09.2020 me vlerë 98,200,000 lekë me TVSH, për ndërtimin e një banese sociale 6k me ambiente shërbimi në katin përdhe si dhe një kat nën tokë në qytetin e Burrelit, është nënshkruar dhe zbardhur marrëveshja dypalëshe midis EKB dhe Bashkisë Mat. Është realizuar kontrata e dhurimit dhe është liru sheshi nga objekti ekzistues nga Bashkia Mat.

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

Aktualisht ky objekt po zbatohet nga shoqëria sipërmarrëse “Cara”SH.P.K & “2T” SH.P.K me vlerë kontrate 80,891,174 lekë me TVSH. Ndërsa mbikëqyrjen e punimeve të këtij objekti po e realizon shoqëria "GB Civil Engineering" shpk.

Puna në objekt ka filluar në datën 22.11.2021 dhe ka afat realizimi 480 ditë kalendarike. Ky objekt pritet të përfundojë ne muajin Prill 2023.

Edhe në këtë objekt puna gjatë stinës së dimrit vijoi me ritme të ngadalta për shkak të problemeve të shkaktuara nga temperaturat e ulëta gjatë muajve Dhjetor, Janar, Shkurt dhe Mars. (Procesi i betonimit nuk mund të kryhej nëse temperaturat ishin më të ulëta se 5°C). Aktualisht në objekt është duke u realizuar përfundimi i karabinasë si dhe vendosja e muraturës në 3 kate banimi dhe shërbimi.

Referuar situatës faktike të punimeve të realizuara në objekt, ecuria e punimeve është 65 % e punimeve ndertimore. Objektivi ynë që ky objekt të përfundojë Brenda 6 mujorit te pare 2023.

Me plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm, regjistrimin final në ASHK të objektit si dhe marrjen e listave përfundimtare të familjeve nga Bashkia Mat, EKB do të vijojë me shitjen e apartamenteve, garazheve si dhe njësisive të shërbimit. Kjo parashikohet të realizohet brenda vitit 2023.

7. Banesë 6k në qytetin e Delvinës – Bashkia Delvinë (29 apartamente)

Për investimin e miratuar me vendim Nr.63, dt 29.12.2020 me vlerë 100,700,000 lekë me TVSH, për ndërtimin e një banese sociale 6k në qytetin e Delvinës. Aktualisht ky objekt po realizohet nga shoqëria sipërmarrëse “Viante” SH.P.K & “ED-Konstruksion” SH.P.K. me vlerë 82,106,261 lekë me TVSH me një ulje prej 10% nga Fondi Limit i Prokuruar. Shoqëria Mbikëqyrëse është BOE “Lead Consulting” SH.P.K. & “KKG Project” SH.P.K.

Puna në objekt ka filluar në 15.01.2022 dhe afati i realizimit të objektit është 480 ditë kalendarike. Punimet janë ndërprerë në datë 09.04.2022, ku shoqëria sipërmarrëse ka sjellë pezullimin e tyre për shkak të rritjes së çmimeve të matërialeve të ndërtimit bazë (hekur, beton, etj.). Punimet kanë rifilluar në 01.09.2022. Janë realizuar punime te karabinase deri ne katin e trete.

Referuar situatës faktike të punimeve të realizuara në objekt, ecuria e punimeve është 35 % e punimeve ndertimore..

Me plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm, regjistrimin final në ASHK të objektit si dhe marrjen e listave përfundimtare të familjeve nga Bashkia Delvine , EKB do të vijojë me shitjen e apartamenteve,. Kjo parashikohet të realizohet brenda vitit 2023, ose tremujorin e pare 2024.

8. Banesë dhe shërbime 6k në qytetin e Shijakut–Bashkia Shijak (25 apartamente)

Për investimin e miratuar me vendim Nr.55, dt 16.11.2020 me vlerë 99,200,000 lekë me TVSH, për ndërtimin e një banese sociale 6k me ambiente shërbimi në katin përdhe si dhe një kat nën tokë në qytetin e Shijakut, është zbardhur Akt-Marrëveshja midis EKB-së dhe Bashkisë Shijak si dhe është realizuar kontrata e dhurimit të truallit.

Me marrjen e Çertifikatës së Pronësisë së truallit, e cila daton 08.09.2021, paralelisht EKB ka zhvilluar gjithë procedurat për realizimin e Vlerësimit të ndikimit në mjedis, studimit gjeologjik/sizmik si dhe gjithë hapat e nevojshëm tekniko-ligjorë që nevojiten për nxjerrjen e Lejes së Ndërtimit.

Ky objekt është në procedurë prokurimi. Me daljen e Lejes së Ndërtimit dhe lidhjen e kontratave respektive me shoqërinë sipërmarrëse dhe mbikëqyrëse për realizimin e objektit do të nisë edhe puna. Kjo parashikohet të realizohet brenda tremujorit të parë të vitit 2023.

Drejtoria Teknike gjatë vitit 2023 planifikon të ndjekë ecurinë e investimit dhe zgjidhjen e çdo problematike të lindur në mënyrë që të arrihet realizimi i 80% të punimeve të objektit.

9. Banesë 6k në qytetin e Roskovecit – Bashkia Roskovec (25 apartamente)

Për investimin e miratuar me vendim Nr.66, dt 29.12.2020 me vlerë 100,700,000 lekë me TVSH, për ndërtimin e një banese sociale 6k si dhe një kat nën tokë në qytetin e Roskovecit, është zbardhur Akt-Marrëveshja midis EKB-së dhe Bashkisë Roskovec.

Ky investim është përgatitur i gjithe dokumentacioni teknik dhe ligjor. Kemi siguruar nepermjet Bashkise Roskovec kalimi i pronësisë së truallit në datë 11.01.2022 si dhe është zbardhur Leja e Zhvillimit.

EKB ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për fillimin e realizimit të investimit në këtë qytet brenda 3 mujorit të parë të Vitit 2023.

Gjithashtu EKB, edhe nëpërmjet shprehjes së interesit me organet e vetëqeverisjes vendore, ku është kërkuar zgjerimi i bashkëpunimit për të siguruar sheshe ndërtimi për ndërtimin e banesave me kosto të ulët për strehimin e familjeve të pastreha sikurse është planifikuar të ndërtohet në qytete Berat, Tropoja 2, Sarandë dhe Gjirokastrë, për të cilin ka patur disa takime/komunikime dhe korrespondenca ndërinstytucionale.

10. Banesë dhe shërbime 6k në qytetin e Sarandës– Bashkia Sarandë (25 apartamente).

Referuar takime/ komunikimeve dhe korrespondencës ndëristitucionale, Bashkia Sarandë ka shprehur interes për ndërtimin e një banese banimi dhe shërbimi 6kat dhe një kat parkimi nën tok, me qëllim strehimin e familjeve të pastreha të kësaj Bashkie. Fondi i parashikuar për ndërtim është 105,740,000 lekë me TVSH.

Drejtoria Teknike, pas vendosjes në dispozicion të truallit nga ana e Bashkisë Sarandë, gjatë vitit 2023 do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për fillimin e realizimit të investimit dhe planifikon të ndjekë ecurinë e investimit dhe zgjidhjen e çdo problematike të lindur në mënyrë që të arrihet realizimi i mbi 50% të punimeve të objektit.

11. Banesë dhe shërbime 6k në qytetin e Gjirokastrës – Bashkia Gjirokastrë (25 apartamente).

Referuar takime/ komunikimeve dhe korrespondencës ndëristitucionale, Bashkia Gjirokastrë ka shprehur interes për ndërtimin e një banese banimi dhe shërbimi 6kat dhe një kat parkimi nën tok, me qëllim strehimin e familjeve të pastreha të kësaj Bashkie. Fondi i parashikuar për ndërtim është 105,740,000 lekë me TVSH.

Drejtoria Teknike, pas vendosjes në dispozicion të truallit nga ana e Bashkisë Gjirokastrë gjatë vitit 2023 do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për fillimin e realizimit të investimit dhe planifikon të ndjekë ecurinë e investimit dhe zgjidhjen e çdo problematike të lindur në mënyrë që të arrihet realizimi imbi 50% të punimeve të objektit.

12. Banesë 6k në qytetin e Tropojës – Bashkia Tropojë (Tropoja 2 - 30 apartamente).

Kërkesa e Bashkisë Tropojë i referohet investimit të miratuar me vendim Nr. 28 datë 08.07.2020, përfshihet ndërtimi i 2 godinave “Godinë nr.1 banimi dhe shërbimi 6 kat dhe një kat parkimi nën tokë” i cili është drejt përfundimit si dhe “Godinë nr. 2 banimi 6 kat dhe një kat parkimi nën tokë”. Referuar takimeve/komunikimeve dhe korrespondencës midis dy institucioneve, Bashkia Tropojë ka vënë në dispozicion sheshin përkatëse me qëllim strehimin e familjeve të pastreha, si rezultat i lëvizjes së popullatës nga fshtrat në qytetin e Bajram Currit. Fondi i parashikuar për ndërtim është 103,720,000 lekë me TVSH. Planifikon të ndjekë ecurinë e investimit dhe zgjidhjen e çdo problematike të lindur në mënyrë që të arrihet realizimi imbi 50% të punimeve të objektit.

13. Banesë dhe shërbime 8k në qytetin e Beratit – Bashkia Berat (35 apartamente).

Referuar takime/ komunikimeve dhe korrespondencës ndërstitucionale, Bashkia Berat ka shprehur interes për ndërtimin e një banese banimi dhe shërbimi 8kat dhe një kat parkimi nën tokë, me qëllim strehimin e familjeve të pastreha të kësaj Bashkie. Fondi i parashikuar për ndërtim është 105,740,000 lekë me TVSH.

Drejtoria Teknike, pas vendosjes në dispozicion të truallit nga ana e Bashkisë Berat gjatë vitit 2023 do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për fillimin e realizimit të investimit dhe planifikon të ndjekë ecurinë e investimit dhe zgjidhjen e çdo problematike të lindur në mënyrë që të arrihet realizimi i mbi 50% të punimeve të objektit.

IV. Plani i Aktiviteteve Mbështetëse.

1. Planifikimi i procedurave të prokurimit të parashikuara për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, nga EKB-ja në varësi të stadi të investimeve ndërtimore në proces, vlerësimit të kapaciteteve dhe nevojave për investime të reja, janë parashikuar të realizohen procedurat e prokurimit sipas pasqyrës në vijim.

Në bazë të pasqyrës së investimeve, të parashikuar në programin ekonomik për vitin 2023, në pasqyrën e prokurimeve janë reflektuar zërat (Ndërtim, mbikëqyrje, mirëmbajtje dhe performanca e energjisë) për çdo investim që parashikohet të prokurohet gjatë vitit 2023, me vlerat përkatëse me tvsh për 5 investime të reja në qytetet: Tropojë (Tropoja 2); Sarandë, Roskovec, Berat dhe Gjirokastrë.

Gjithashtu në pasqyrë janë reflektuar zërat e investimeve në proces (Ruajtje objekti, mirëmbajtje, performanca e energjisë faza II, sigurimi dhe të tjera relevante si ekspertiza) që kanë mbetur për tu prokuruar gjatë vitit 2023, të cilat janë mbartur nga viti 2022, me vlerat përkatëse analitike me tvsh për objektet në qytetet: Vlorë (Vlora 1 dhe Vlora 2), Kukës, Has, Tropojë, Burrel, Shijak dhe Delvinë.

Në këtë kuadër është parashikuar dhe prokurimi i një fondi prej 5,000,000 lekë me tvsh për studime sizmike, VNM, gjeologjike, rievime, përshtatje të kuotës 00 etj., për objekte të parashikuara në periudhën 2023-2024.

Pasqyra e procedurave që do të prokurohen gjatë vitit 2023 për investimet e mbartura dhe ato të reja të parashikuara në paqsyren e investimeve.

Në lekë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vlera e investimit që prokurohet gjatë vitit 2023 (me TVSH)
A	Investime të vitit 2023	533,750,000
1	Objekti, Tropoja 2	98,060,000
*	Ndërtim për banesën në Tropojë, nr. 2	96,000,000
*	Mbikqyrje Punimesh banesa në Tropojë, nr. 2	1,200,000
*	Projekt mirembajtje banesa, në Tropojë, nr. 2	60,000
*	Performanca e Energjise faza I, Tropojë nr. 2	800,000
2	Objekti Sarandë	100,060,000
*	Ndërtim për banesën në Sarandë	98,000,000
*	Mbikqyrje Punimesh, banesa në Sarandë	1,200,000
*	Projekt mirembajtjeje, banesa Sarandë	60,000
*	Performanca e Energjise faza I, Sarandë	800,000
3	Objekti Roskovec	98,060,000
*	Ndërtim për banesën në Roskovec	96,000,000
*	Mbikqyrje Punimesh, Roskovec	1,200,000

*	Projekt mirembajtjeje, banesa Roskovec	60,000
*	Performanca e Energjise faza I, Roskovec	800,000
4	Objekti Berat	137,510,000
*	Ndërtim për banesën në Berat	135,000,000
*	Mbikqyrje Punimesh, Berat	1,250,000
*	Projekt mirembajtjeje, banesa Berat	60,000
*	Performanca e Energjise faza I, Berat	1,200,000
5	Objekti Gjirokastrë	100,060,000
*	Ndërtim për banesën në Gjirokastrë	98,000,000
*	Mbikqyrje Punimesh, Gjirokastrë	1,200,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Gjirokastrë	60,000
*	Performanca e Energjise faza I, Gjirokastrë	800,000
B	Investime të mbartur nga viti 2022	24,269,000
1	Objekti Vlora 1	800,000
*	Pagesa e rojeve, Energji elektrike, etj.	800,000
2	Objekti Kukës	600,000
*	Pagesa e rojeve, Energji elektrike, etj.	600,000
3	Objekti Has	4,260,000
*	Kolaudim objekti Has	250,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Has	60,000
*	Performanca e Energjise faza II, Objekti Has	1,200,000
*	Sigurim objekti, Has	1,250,000
*	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, ruajtje objekti, etj.), Objekti Has	1,500,000

4	Objekti Vlorë 2	6,250,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Vlorë 2	60,000
*	Performanca e Energjise faza II, 2 banesa Vlorë 2	2,400,000
*	Kolaudim objekti 2 banesa, Vlorë 2	250,000
*	Sigurim objekti 2 banesa, Vlorë 2	2,040,000
*	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), 2 banesa Vlorë 2	1,500,000
5	Objekti Tropojë	3,550,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Tropojë	60,000
*	Performanca e Energjise faza II, Objekti Tropojë	800,000
*	Kolaudim objekti, Tropojë	200,000
*	Sigurim objekti, Tropojë	990,000
*	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Objekti Tropojë	1,500,000
6	Objekti Burrel	3,369,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Burrel	60,000
*	Performanca e Energjise faza II, Objekti Burrel	800,000
*	Kolaudim objekti, Burrel	200,000
*	Sigurim objekti, Burrel	809,000
*	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Objekti Burrel	1,500,000
7	Objekti Shijak	2,060,000
*	Mbikqyrje Punimesh, Shijak	1,200,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Shijak	60,000
*	Performanca e Energjise faza I, Objekti Shijak	800,000

8	Objekti Delvinë	3,380,000
*	Projekt mirembajtje, Objekti Delvinë	60,000
*	Performanca e Energjise faza II, Objekti Delvinë	800,000
*	Kolaudim objekti, Delvinë	200,000
*	Sigurim objekti, Delvinë	820,000
*	Te tjera (ekspertiza te ndryshme, akti normativ, ruajtje objekti, etj.), Delvinë	1,500,000
C	Studime-projektme (230) për VNM, studime zizmike & gjeologjik, rilevime, raporte ekspertize, rishikim detajesh të projekteve, përshtatje e kuotës 00 etj., të objekteve të parashikuara për periudhën 2023-2024.	5,000,000

Ndërsa për investimet jo ndërtimore, për blerje mobileri-orendi zyrash dhe paisje elektronike, si dhe të shpenzimeve administrative më të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së EKB-së, janë parashikuar të realizohen prokurimet sipas pasqyrës si vijon:

Pasqyra e procedurave që do të prokurohen gjatë vitit 2023 për mobileri e pajisje.

Në lekë

D	Investime për mobileri-paisje	7,970,000
1	Blerje mobileri dhe orendi zyrash	320,000
2	Blerje paisje elektronike	2,500,000
3	Blerja e programit per kontabilitetin , llogaritjen automatike te kesteve te kredise dhe menaxhimin e klienteve	5,000,000
4	Blerje Kondicioneresh	150,000
	TOTALI (A+B+C+D)	570,989,000

Pasqyra e procedurave që do të prokurohen gjatë vitit 2023 për shpenzime të veprimtarisë.

Në lekë

Nr.	Objekti i prokurimeve	Plani vjetor i prokurimit të shpenzimeve	
		2022	2023
A	Shpenzime të veprimtarisë		
1	Blerje Karburant	1,000,000	1,200,000
2	Blerje Materiale Kancelarie	634,000	500,000
3	Blerje Tonera Për Fotokopje Dhe Printera	520,000	700,000
4	Blerje Pjesë Elektrike	100,000	100,000
5	Blerje pjesë hidraulike	100,000	50,000
6	Blerje pjesë elektronike	100,000	100,000
7	Blerje materiale higjeno sanitare, produkte dezinfektimi, maska	636,000	450,000
8	Rritja e kapaciteteve te emaileve zyrtar	60,000	60,000
9	Blerja e programit per antiviruse		300,000
10	Abonimi i programit te fiskalizimit	100,000	150,000
11	Shërbime për programin Alpha dhe trajnime të specialistëve të financës etj.	400,000	200,000
12	Mirëmbajtja e faqes zyrtare të EKB-së	120,000	120,000
13	Riparimi i automjeteve	800,000	900,000
14	Goma per automjetet		190,000
15	Shërbim- larje e automjeteve	120,000	120,000
16	Siguracioni i automjeteve dhe taksa	150,000	150,000
17	Blerje mallra për pritje	80,000	100,000
18	Riparim fotokopje dhe printera	120,000	80,000

19	Blerje bileta për udhëtime jashtë vendit	300,000	300,000
20	Riparime kondicionerësh	120,000	80,000
21	Riparime hidraulike	50,000	50,000
22	Organizim seminare, trajnime, etj.	120,000	120,000
23	Reklamime në TV për shitjen e dyqaneve	100,000	50,000
24	Shërbime për dizefektimin e zyrave	500,000	100,000
25	Ekspert i jashtëm për hartimin e planit strategjik		100,000
	TOTAL	6,230,000	6,270,000

2. Subvencionimi i interesave të kredive me kushte lehtësuese dhe trajtimi me kredi i familjeve qiramarrëse në ish pronë private.

Në zbatim të politikave të strehimit të miratuara nga shteti dhe detyrave i janë ngarkuar me aktet ligjore e nënligjore përkatëse për subvencionimin e interesave në përputhje me buxhetin e miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë qëllim, EKB do të vazhdojë gjatë vitit 2023 të kryejë procesin e trajtimit me kredi me kushte lehtësuese, në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, për:

- trajtimin me kredi me kushte lehtësuese me 0% interes në vit për të gjithë familjet e pastreha që banojnë në pronat e subjekteve të shpronësuara.
- subvencionimin e interesave të kredive për familjet e pastreha që janë trajtuar me kredi të lehtësuara me 3% interes në vit nga bashkitë respektive.
- subvencionimin e interesave të kredive për punonjësit e administratës së lartë shtetërore që kanë përfituar kredi të lehtësuara me 4 % interes në vit.

3. Zbatimi dhe rishikimi i legjislacionit ku mbështetet veprimtaria e institucionit

do të mbështesë veprimtarinë nëpërmjet zbatimit të legjislacionit përkatës në fuqi dhe njëkohësisht do të punojë për të përmirësuar këtë legjislacion duke përqendruar punën në këto drejtime:

- a) Hartim të propozimeve për ndërmarrje iniciative ligjore për aktet e evidentuara dhe të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme, ndjekje të iniciativave të propozuara pranë MFE gjatë vitit 2022 dhe që ende nuk janë miratuar, si edhe dhënie mendimi mbi propozimet e ardhura nga ministritë apo institucionet përkatëse lidhur me iniciativat ligjore që mund të ndërmeren nga këto të fundit .

- b) Hartim të akt-marrëveshjeve të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe me institucione të tjera në funksion të ndjekjes dhe zbatimit të politikave të strehimit për familjet në nevojë.
- d) Hartim apo përpunim të akteve normative të institucionit, kontratave tip apo udhëzimeve të brendshme sipas nevojave të institucionit që mund të prezantohen gjatë vitit 2023 me qëllimin për të qartësuar, saktësuar dhe përmirësuar procedurat që kryhen nga strukturat përbërëse të EKB-së, në zbatim të detyrave funksionale dhe atyre të ngarkuara, për të arritur realizimin e objektivave të përcaktuara.

4. Ndjekja dhe monitorimi i proceseve gjyqësore

- Ndjekja dhe monitorimi i proceseve gjyqësore për vitin 2023 do të kryhet në bashkëpunim me strukturat në qendër si dhe të gjitha strukturat në rrethe, me qëllim monitorimin si dhe përfaqësimin e këtyre proceseve në të gjitha shkallët e gjykimit në një nivel profesional, duke u përqëndruar në drejtim të:
 - Ndjekjes në vazhdimësi të proceseve të evidentuara që nga viti paraardhës që janë aktualisht në proces gjykimi dhe do vijojnë të ndiqen edhe gjatë vitit 2022 nga strukturat përkatëse të EKB-së.
 - Hapjes së proceseve të reja gjatë vitit 2023 nga Degët Rajonale ndaj klientëve debitorë në zbatim të Manualit të Menaxhimit të Debitorëve ku sipas planifikimit të këtyre degëve janë parashikuar të hapen 89 procese gjyqësore gjatë këtij viti, pasqyruar dhe specifikuar sipas degëve rajonale në tabelën bashkëlidhur materialit;
 - Ndjekjes së proceseve të tjera të paparashikuara të cilat mund të hapen gjatë vitit 2023 ndaj EKB-së nga persona juridikë apo fizikë, si dhe të proceseve gjyqësore që mund të hapë vetë EKB në rastet kur strukturat përkatëse në varësi të problematikave të evidentuara dhe në zbatim të detyrave që u janë ngarkuar, relatojnë kërkesën së bashku me materialet e provat për hapjen e proceseve gjyqësore, mbështetur në gjurmën e auditit për proceset gjyqësore të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi brenda afateve të parashkrimit.

5. Kryerja e procedurave përkatëse në funksion të veprimtarisë që kryen Këshilli Drejtues i Entit Kombëtar të Banesave

- Gjatë vitit 2023, referuar Programit Vjetor të Veprimtarisë së Këshillit Drejtues që do të miratohet për këtë vit kalendarik, si dhe në varësi të problematikave të ndryshme të dala gjatë kryerjes së veprimtarisë së përditshme të institucionit, do të përgatiten nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme materialet përkatëse të cilat do t'i paraqiten Këshillit Drejtues për shqyrtim dhe vendimarrje.

Bashkëlidhur këtij relacioni si pjesë përbërëse tij janë tabelat;

- Tabela 1, Pasqyra e të ardhurave
- Tabela 2, Pasqyra e shpenzimeve
- Tabela 3, Pasqyra e rezultatit financiar

- Tabela 4, Pasqyra e Cash-Flow
- Tabela 5, Pasqyra e arkëtimeve
- Tabela 6, Pasqyra e financimit të investimeve dhe shpenzimeve të veprimtarisë
- Tabela 7, Pasqyra e prokurimeve të investimeve dhe shpenzimeve
- Tabela 8, Parashikimi i ecurisë së likuidimit të investimeve
- Tabela 9, Planifikimi I shitjeve të njësive të shërbimit dhe garazheve
- Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme
- Tabela e proceseve gjyqësore të planifikuara për të hapur gjatë vitit 2023